

PROCESVERBAL

Nga Seanca e parë Konstituive e Këshillit të Komunës së Bërvenicës
mbajtur më 25.11 2021 me fillim në ora 12

Seancën e hapi kryetari i përbërjes së fundit të Këshillit të Komunës së Bërvenicës, Micko Kostadinovski dhe tha, i dëshiroj urime Këshillit të ri, përshëndes administratën dhe e përgëzoj kryetarin e ri të komunës të cilit gjithashtu i dëshiroj punë të suksesshme dhe të frytshme.

Shërbimi u ndërlidh dhe tha, përshëndetje për të gjithë dhe në fillim t'ju them se sot nuk do të ketë thirrje për pjesëmarrje, por fillimisht duhet të konstituohet Këshilli.

Adem Jashari mori fjalën dhe kërkoi një minutë heshtje në nderim të të vrarëve në aksidentin e rëndë trafiku në autobusin tonë që kalonte nëpër Bullgari.

Micko Kostadinovski tha se kjo është një seancë konstituive, ka një rend dite që ka pesë pika punuese dhe nëse keni ndonjë ndryshim në rend dite mund ta shtoni.

Për punimin e seancës u propozua rendi i ditës si në vijim:

1. Propozim-vendim për zgjedhjen e Komisionit për verifikim, çështje të mandatit, zgjedhje dhe emërime.
2. Propozim-Vendim për Verifikimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit të Komunës së Bërvenicës.
3. Propozim-Vendim për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit të Komunës së Bërvenicës.
4. Propozim-Vendim për emërimin e këshilltarëve të autorizuar për lidhjen e martesave në territorin e komunës së Bërvenicës.
5. Propozim-Vendim për autorizim të nënshkruesit të xhirollogarive të komunës së Bërvenicës.

Meqenëse askush nuk u paraqit për ta shtuar rendin e ditës, Kryetari i përbërjes së kaluar Micko Kostadinovski e vuri në votim rendin e ditës dhe njëzëri u pranua.

I

Për pikën e parë të rendit të ditës, Propozim-vendim për zgjedhjen e Komisionit për verifikim, çështje të mandatit, zgjedhje dhe emërime, Micko Kostadinovski sqaroi Komisionin Verifikues dhe mënyrën e formimit të tij.

Shërbimi Juridik shtoi gjithashtu se Komisioni Verifikues duhet të formohet me 5 anëtarë dhe një anëtar nga secila parti politike, ndërsa Kryetari duhet të jetë nga partia politike që ka fituar më shumë mandate për këshilltarë në zgjedhjet e fundit vendore.

Micko Kostadinovski bëri thirrje që të propozohen kandidatë për anëtarë të Komisionit Verifikues.

Abeb Nuhiji propozon Bujamin Rushitin.

Miroslav Daillovski propozon Donço Simjanoskin.

Adem Jashari (F) propozon Adem Jashari nga Gurgurnica.

Svetlana Stamatovska propozon Zlate Kitanovskin.

Alihasan Idrizi propozon Emin Medijin.

Për anëtarët e Komisionit Verifikues u propozuan:

1. Donço Simjanovski,
2. Bujamin Rushiti,
3. Adem Jashari,
4. Zllate Kitanovski dhe
5. Emin Mediji.

Poashtu për Kryetar të Komisionit Verifikues u zgjodh Donço Simjanovski

Micko Kostadinovski e vendosi pikën e parë të rendit të ditës në votim vendim për zgjedhjen e Komisionit për verifikim, çështje të mandatit, zgjedhje dhe emërime dhe u pranua njëzëri nga 14 këshilltarët e pranishëm

II

Për pikën e dytë të rendit të ditës, Propozim-Vendim për Verifikimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit të Komunës së Bërvenicës. Micko Kostadinovski e lexoi dhe tha, për shkak se anëtarët e komisionit janë zgjedhur, tani jap një pushim prej 5-10 minutash për të shqyrtuar vendimet ose vërtetimet e këshilltarëve.

Nga shërbimi juridik tha se sipas rregullores tani do t'i shqyrtojmë vërtetimet me kushtet, të lexoni dhe firmosni deklaratat, ndërsa për personin që nuk është i pranishëm mandati do të verifikohet në seancën e radhës ku do të jetë i pranishëm.

Kryetari i Komisionit Verifikues tha se komisioni është mbledhur, ka shqyrtuar certifikatat e të gjithë këshilltarëve dhe ka konstatuar se nuk ka asnjë pengesë për nënshkrimin e deklaratave, përkatësisht verifikimin e mandateve të të gjithë këshilltarëve përveç një këshilltari që jep dorëheqje nga mandati.

Deklaratat e të gjithë këshilltarëve shpërndahen nga shërbimi juridik.

Micko Kostadinovski tha, të gjithë do të bëheni dhe të gjithë do ta lexojnë deklaratën e tyre dhe me atë deklaratë, gjegjësisht me nënshkrimin e saj, ju zyrtarisht bëheni anëtar i Këshillit të Komunës së Bërvenicës.

Këshilltarët lexuan deklaratat dhe i firmosën, pastaj Vendimi për Verifikimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit të Komunës së Bërvenicës u hodh në votim dhe u miratua njëzërit nga 14 këshilltarët e pranishëm.

III

Për pikën e tretë të rendit të ditës, Propozim-Vendim për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit të Komunës së Bërvenicës, Micko Kostadinovski e lexoi atë dhe tha se ju duhet një pushim prej pesë minutash për të rënë dakord për këtë pikë.

Abeb Nuhii mori fjalën dhe tha, nuk ka nevojë për pushim, ne do të sugjerojmë këtu.

Micko Kostadinovski shpjegoi procedurën për zgjedhjen e kryetarit.

Edhe shërbimi juridik u ndërlidh dhe tha që pasi të propozoni kandidatët për kryetar, secili ka të drejtë të votojë vetëm për njërin nga kandidatët, sigurisht nëse ka më shumë të nominuar.

Micko Kostadinovski tha, tani mund të propozoni.

Abeb Nuhii ka propozuar Bujamin Rushitin për kryetar të Këshillit Komunal të Bërvenicës.

Micko Kostadinovski pyeti nëse ka ndonjë propozim tjetër.

Meqenëse nuk kishte asnjë propozim tjetër për kryetar të Këshillit përveç Bujamin Rushitit, Micko Kostadinovski e hodhi në votim Vendimin për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit të Komunës së Bërvenicës propozimin dhe u pranua nga 8 këshilltarë PRO dhe 6 këshilltarë abstenuan.

Micko Kostadinovski tha se kryetar i Këshillit është zgjedhur Bujamin Rushit dhe i lëshoi vendin për të udhëhequr me këshillin.

Bujamin Rushiti, gjegjësisht kryetari i posazgjedhur i Këshillit tha, faleminderit të gjithëve për nominimin dhe zgjedhjet, nuk do të jem ndryshe nga më parë, qëllimi ynë është të marrim vendime të mira, e përgëzoj kryetarine komunës, ndoshta ndonjë herë do të kemi mosmarrëveshje por e di që do ti kalojmë, faleminderit për kryetarin e Këshillit të kaluar Micko Kostadinoskin.

IV

Për pikën e katërt të rendit të ditës, Propozim-Vendim për emërimin e këshilltarëve të autorizuar për lidhjen e martesave në territorin e komunës së Bërvenicës kryetari i Këshillit, e lexoi atë dhe tha se çdo këshilltar ka të drejtë të marrë pjesë në lidhjen e martesave në vendbanimet e ku kan zyrat e ofiçarve të tyre, por do të pyes nëse dikush nuk dëshiron.

Me qenë se askush nuk kërkoi fjalë, Kryetari i Këshillit hodhi në votim pikën e katërt të rendit të ditës Vendim për emërimin e këshilltarëve të autorizuar për lidhjen e martesave në territorin e komunës së Bërvenicës, e cila u pranua njëzëri nga 14 këshilltarët e pranishëm.

V

Për pikën e pestë të rendit të ditës, Propozim-Vendim për autorizim të nënshkruesit të xhirollogarive të komunës së Bërvenicës kryetari i Këshillit e lexoi dhe tha, ligji parashikon që kryetari i komunës të jetë nënshkrues i xhirollogarive dhe do ta hedh në votim.

Kryetari i Këshillit hodhi në votim Vendimin për autorizim të nënshkruesit të xhirollogarive të komunës së Bërvenicës dhe u pranua njëzëri nga 14 këshilltarët e pranishëm.

Seanca e parë e Këshillit të Komunës së Bërvenicës përfundoi me shterimin e pikave të rendit të ditës.

Procesverbalist; Natsha Stojçeska

Nr.08-1718/2
25.11.2021
Bërvenicë

Këshilli i Komunës së Bërvenicës
K r y e t a r,
Bujamin Rushiti